



Prishtinë: 28.08.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1175_1_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1966_07_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **15.08.2019**.

në seancën e mbajtur më datë **28.08.2019**, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin I. R., nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DPR 75354, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1966_07_19** i datës 18.07.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 15.08.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: energjia e shpenzuar nga konsumatori është matur në njehsorin nr.32412949 dhe se gjatë verifikimi në qendrën e kalibrimit ka rezultuar në rregull. Në ankesë është theksuar se vendimi i DMK në ZRRE është i bazuar vetëm në krahasimin e shpenzimit të energjisë elektrike dhe konstatimi i ZRRE-së se shpenzimi i energjisë nuk mund të jetë i drejtë nuk është i bazuar në prova. Në ankesë theksohet se nuk është arsyetim se konsumatori jeton jashtë vendit pasi që konsumatorët kthehen për pushime dhe bëjnë shpenzime, dhe për këtë KESCO ka bërë shpërndarjen e shpenzimit për periudhat 06/215 dhe 07/2015. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1966_07_19 i datës 18.07.2019 për konsumatorin I. R. me shifër DPR – 75354.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.08.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se energjia e shpenzuar nga konsumatori është matur në njehsorin nr.32412949 dhe se gjatë verifikimi në qendrën e kalibrimit ka rezultuar në rregull, Bordi i ZRRE-së thekson se edhe organi i shkallës së parë në ZRRE gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka



konstatuar se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.32412949 e evidentuar procesverbalin e inspektimit nr.0756622 të datës 27.07.2015 përputhet me gjendjen e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive, si dhe gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.32412949 e evidentuar në procesverbalin e inspektimit nr.1187568 të datës 20.10.2015 përputhet me gjendjen e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive. Megjithatë Bordi i ZRRE-së thekson se konsumatori pas arritjes së faturës së energjisë elektrike të muajit 07/2015 ka parashtruar ankesë në KESCO duke theksuar se ai gjendet jashtë Kosovës dhe se siguresat kanë qenë të ndalura, por që njehsori ka punuar edhe pse kanë qenë të ndalura siguresat, andaj është dyshuar në matje jo të saktë të njehsorit, por që punëtorët e autorizuar të KEDS-it edhe përkundër që kanë dalur te konsumatori për të verifikuar pikën matëse nuk kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme si ndërrimin e njehsorit elektrik dhe dërgimin e tij në qendrën e kalibrimit për verifikim/shqyrtim, kur dihet se konsumatori ka dyshuar në matjen e njehsorit elektrik dhe kur dihet se papritmas konsumatorit i ka arritur fatura mujore prej 3,481 kWh dhe atë si shpenzim mujor. Andaj Bordi i ZRRE-së thekson se KEDS nuk ka vepruar sipas rregullave dhe procedurave në fuqi, e që kur dyshohet në matjen e njehsorit elektrik atëherë është përgjegjësi e KEDS-it të bëjë ndërrimin e pikës matëse dhe dërgimin e tij për në Qendrën e Kalibrimit për verifikim/shqyrtim të saktësisë.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit së KESCO-s se vendimi i DMK në ZRRE është i bazuar vetëm në krahasimin e shpenzimit të energjisë elektrike dhe konstatimi i ZRRE-së se shpenzimi i energjisë nuk mund të jetë i drejtë nuk është i bazuar në prova, Bordi i ZRRE-së thekson se krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese është një indikator shumë i rëndësishëm gjatë shqyrtimit të ankesës së konsumatorit dhe se natyrisht që duhet të merret parasysh. Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike vërehet se konsumatori nga periudha 04/2003 e deri më 08/2013 ka lexim dhe faturim të shpenzimit të energjisë elektrike, ndërsa nga periudha 09/2013 e deri më 06/2015 nuk ka shpenzim të harxhuar e të faturuar dhe se është faturuar vetëm me taksë, përveç periudhave 05/2014 dhe 08/2014 dhe 09/2014 kur kemi faturim shumë të ulët, si dhe në periudhën 07/2015 kemi faturim prej 3,148 kWh si shpenzim mujor, pastaj në muajin 08/2015 kemi faturim prej 149 kWh, ndërsa nga periudha 09/2015 e tutje pothuajse në të gjitha periudhat kemi faturim vetëm me taksë përveç disa periudhave (08/2016, 09/2016, 08/2017, 09/2017, 09/2018, 01/2019, 02/2019), por që me shpenzim të ulët. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se konsumatori nga periudha 09/2013 e tutje, përveç periudhës kontestuese, pothuajse në të shumtën e periudhave tjera ka faturim vetëm me taksë dhe pa shpenzim. Andaj Bordi i ZRRE-së thekson se duke u bazuar edhe në shpenzimet e mëhershme të konsumatorit para periudhës kontestuese, si dhe në periudhat edhe pas periudhës kontestuese, shihet qartë se shpenzimi i muajit 07/2015 nuk paraqet shpenzim real mujor, madje as për së afërmi nuk përputhet shpenzimi i muajit 07/2015 me atë të periudhat tjera, andaj Bordi konstaton se shpenzimi i energjisë elektrike është provë në shqyrtimin e lëndës së konsumatorit.

Bordi i ZRRE gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke pasur parasysh se shpenzimi i energjisë elektrik i muajit 07/2015 është shpenzim shumë më i lartë se periudhat tjera para dhe pas periudhës 07/2015, si dhe duke pasur parasysh se KEDS nuk ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik dhe dërgimit të tij për në qendrën e kalibrimit për shqyrtim të saktësisë në mënyrë që të verifikohet njehsori elektrike edhe përkundër dyshimit të konsumatorit në matjen e saktësisë, konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë i ZRRE-së është i saktë dhe i bazuar në prova konkrete, andaj konstaton se KESCO duhet ta shkarkoj konsumatorin nga fatura nr.07150DPR-75354 të datës 25.07.2015 dhe se për atë muaj ta ngarkoj konsumatorin me shpenzimet e njëjta të periudhës 08/2015.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk



është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.08.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit I. R. dhe
- Arkivit të ZRRE-së